

## REACTIONS OF ALBANIAN LANGUAGE STANDARD VIS-À-VIS OF THE FOREIGN LANGUAGE INFLUENCES

### REAGIMET E STANDARDIT TË SHQIPES PËRBALLË PRESIONIT TË GJUHËVE TË HUAJA

SHPRESA HOXHA

Fakulteti Ekonomik, Universiteti I Prishtinës, Rr. Agim Ramadani, p.n., Prishtinë, REPUBLIKA E KOSOVËS  
shppreessaa@hotmail.com

AKTET V, 4: 780-784, 2012

#### PËRMBLEDHJE

Zhvillimi i hovshëm shoqëror, politik, ekonomik, kulturor dhe në veçanti ai teknik kanë bërë shumë ndryshime në të gjitha fushat e jetës tek ne dhe në botë. Andaj edhe gjuha shqipe ka pësuar dhe vazhdon të pësojë ndryshime, të pasurohet, njëkohësisht duke u ndikuar nga gjuhët e huaja përreth saj. Nga historia na janë të njohura ndikimet nga latinishtja, greqishtja, turqishtja dhe sllavishtja, ndërsa sot ndeshemi me huazime nga anglishtja. Theks i veçantë mund t'i vihet zhvillimit dhe njësitit të terminologjisë ekonomike dhe teknike – kryesisht nga kibernetika, digjitalizimi, etj. Megjithatë, nuk mund të tregohemi tejet puristë për termat që tashmë përdoren pothuajse në të gjitha gjuhët e botës. Fjalët dhe shprehjet e huazuara, që mund të formohen me fjalë të përshtatshme shqipe janë: password = fjalëkalim; buton = sustë, pullë; asete = pronë, pasuri, etj.

**Fjalët kyçe:** standardi, huazimet, anglicizmat, sllavizmat, turqizmat.

#### SUMMARY

Rapid social, political, economic, cultural and technical development made great changes in all fields of life at us and in the world. Therefore, Albanian suffered and is still suffering changes. At the same time, it's enriched and influenced by foreign languages around it. From the history we are familiar with Latin, Greek, Turkish, and Slavic influences, while nowadays we are also faced with English loan-words. A special emphasis may be put to the development and unification of the economic and technical terminology – chiefly from cybernetics, digitalization, etc.. However, we can't keep a distance toward the terms that are used almost all over the world especially in cybernetics. The loan-words and expressions that may be formed by appropriate Albanian words are: password = fjalëkalim; button = sustë, pullë; feedback = prapaveprim; assets = pronë, pasuri, etc.

**Key words:** standard, loanwords, Anglicisms, Slavonisms, Turkish loanwords.

#### HYRJE

Punimi në fjalë është përqendruar në përpjekjen e ruajtjes së fjalëve dhe shprehjeve të mirëfillta shqipe dhe mbrojtjen e standardit të gjuhës, kryesisht nga huazimet angleze të kohëve të fundit, ndikimi i huazimeve sllave të mëhershme në Kosovë dhe atyre turke që mbetën të pashlyeshme qysh nga periudha e sundimit të Perandorisë Osmane, jo vetëm tek shqiptarët dhe gjuha shqipe por edhe në mbarë Ballkanin dhe popujt e tij në përgjithësi.

Arsyeja se përdorimi i fjalëve të huaja është shtuar dukshëm në gjuhën shqipe dëshmon fakti i përdorimit të tyre vend e pa vend jo vetëm në gjuhën e folur por edhe në atë të shkruar. I dëgjojmë këto fjalë në media të ndryshme, i lexojmë në shtypin tonë të përditshëm dhe në atë periodik, i ndeshim edhe në tekste të ndryshme shkollore dhe universitare. Madje shumë prej tyre kanë hyrë edhe në fjalorët e botuar të gjuhës shqipe dhe të atyre prej dy e më shumë gjuhësh.

Nga kjo që u tha më sipër nuk do të thotë se ne duhet ta pastrojmë në tërësi gjuhën tonë, por qëllimi i këtij punimi është që të zbutet përdorimi i panevojshëm i anglicizmave si edhe i huazimeve të gjuhëve të tjera me të cilat është ndikuar dhe po ndikohet gjuha shqipe.

### Huazimet angleze

Huazimet angleze, të cilat janë të pranishme në numër të konsiderueshëm fjalësh dhe shprehjesh, në Kosovë kanë vërshuar veçanërisht në periudhën e pasluftës me ardhjen e ndërkombëtarëve dhe qëndrimit të tyre për më tepër se një dekadë. Atë që dikur e ka bërë turqishtja dhe serbokroatishtja sot, këtë ndikim në gjuhën shqipe po e zëvendëson në masë shumë të madhe anglishtja.

Çështja është që të mos injorohen, në të shumtën e rasteve, fjalët shqipe sidomos aty ku ka mundësi të përdoren nga gjuha burimore, e veçanërisht në përkthimet nga njëra gjuhë në tjetrën etj. Për shembull lexojmë në shtypin e përditshëm, i dëgjojmë në programet e radios dhe të televizionit shprehjet dhe fjalët e huajtura në vend se ato të përdoren në gjuhën burimore: fidbek = prapaveprim, grantim = paradhënie për lirim, penetroj = përkthoj, depërtoj, suplement = shtesë, shtojcë [1: faqe 795], folder = mbulesë, mbështjellëse (shkresash), risk = rrezik, opinion = mendim, prosperitet = përparim, leadershipi kosovar = udhëheqësia kosovare, broker = ndërmjetësues, fibra = fije, eksplorues = gjurmues, hulumtues, separate = të ndara, diskrepancë = mospërputhje, mospajtje, bord = këshill, permanent = i përhershëm, akomodim = strehim, vendosje, sublime = fisnik, madhështor, etj., koincidencë = rastësi, etj.

Shembujt e mësipërm përdoren me të madhe dhe tani pothuajse janë mishëruar me shqipen. Në anën tjetër ka të tillë që përdoren pa nevojë, për të dëshmuar një nivel intelektual më të lartë në shoqëri, apo përkthehen me huazime angleze për lehtësi personale si p.sh.: impenjim = ngarkesë, animal = shtazor, egzagjeror = zmadhoj, teproj, agrement = ujdj, marrëveshje, prominent = i dukshëm, i mirënjohur, i shquar, disclaimer = mohim, refuzim, digresim = largim, dalje nga

tema, [1: faqe 167] rimbursim = pagim, kthim parash, imposibël = e pamundur, workshop = grup punues, ekip, daunlodo = transfero, hedh në kompjuter, rubrika – gossip = rubrika - thashetheme, suplement = shtesë, plotësim, etj. Edhe pse “huazimi konsiderohet proces i natyrshëm dhe i pandalshëm, dhe se çdo gjuhë zhvillohet e pasurohet edhe me fjalë të gjuhëve të tjera” [2: faqe 19] do të ishte e drejtë dhe me vend që fjalët e huazuara të përdoren si sinonime ose edhe shpjegim i kuptimit dhe jo fillimisht si parësore e madje edhe të anashkalohen, kuptohet aty ku ekziston mundësia e përdorimit në shqipet.

Na është e njohur se risitë teknike janë të vonshme dhe sidomos kibernetika, andaj ka shumë fjalë dhe shprehje të kësaj fushe që shumë popuj në botë i përdorin pothuajse me terminologji të njëjtë, që do të thotë se hë për hë nuk ka fjalë adekuate edhe në shqipet ose edhe janë në formim e sipër, si për shembull: feisbuk, uindouz, uord, eksell, pauer point, sait, internet, intranet, mesengjer, flash (USB); për adresën elektronike: Hotmail, haker për: pirat informatik, [1: faqe 301] pleisteishën, intership, ajfon, ipad, itouch, postpaid, prepaid, (dy të fundit për parapagime të telefonisë mobile “Vala”), etj.

Madje mund të thuhet lirisht se fjalët e mësipërme më me dëshirë dhe më me lehtësi i përdorim në gjuhën angleze edhe nëse ca prej tyre i kanë përkthimet përkatëse në shqipet.

Ne edhe më herët jemi ndikuar nga fjalët angleze, në mes tjerash edhe për llojet e lojërave të ndryshme sportive, por ato janë marr dhe janë përvetësuar me dekada të tëra si: futboll, basketboll, vaterpolo, hendboll, volejbol, tenis, hokej, reket, slalom, nokaut, gol, etj.

Tek këta shembuj është bërë përshtatja transmorfematike që nënkupton zëvendësimin në rrafshin morfologjik të tyre.

Ndikimi i kësaj gjuhe të folur në shumë vende në botë dhe që tek popujt e shumtë e edhe shqiptarët ka ndikim të vazhdueshëm përmes kinematografisë, muzikës, radios, televizionit, internetit, etj. është pothuajse e pamundur të pengohet për shkak të shpejtësisë së efektit të

tyre jo vetëm në gjuhë por edhe në kulturë përgjithësisht.

### Huazimet sllave

Sa iu përket gjuhëve sllave dhe popujve që i flasin këto gjuhë, shqipja dhe shqiptarët janë ndikuar nga afërsia gjeografike dhe bashkëjetesa shekullore me këta popuj në ish Jugosllavi dhe jashtë saj. Sllavizmat kanë depërtuar në gjuhën shqipe kryesisht gjatë pushtimeve bullgare dhe serbe në provincat ballkanike gjatë shekullit VII, VIII e IX. E. Çabej me të drejtë konstaton se “Këto marrëdhënie të Shqiptarëve dhe Sllavëve kanë zgjatur përafërsisht tetë shekuj me radhë, kanë lënë gjurmët e tyre në gjuhë”. Këtë konstatim e ka dhënë me rastin e studimit të huazimeve të gjuhëve të huaja në temën: “Marrëdhëniet e shqipes në periudhën e saj historike” [3: 45 – 60]. “Marrëdhëniet që kanë pasur shqiptarët dhe sllavët e jugut gjatë historisë së tyre kanë lënë gjurmët edhe në gjuhët që ata flisnin. Në krahinat anësore të këtyre popujve kontaktet dhe marrëdhëniet e fqinjësisë kanë vazhduar për një kohë më të gjatë dhe kanë qenë më intensive, prandaj vetvetiu kuptohet se gjurmët në të folmet e atyre krahinave janë më të shumta. Sigurisht për shkaqe të ndryshme, kanë hyrë më shumë elemente nga sllavishtja në shqipen se sa anasjelltas, por nuk janë të pakta edhe faktet që flasin për një dukuri të kundërt”. [4: faqe 157] Është dukuri normale të jetë i pranishëm ndikimi i njëjës gjuhë në tjetrën për shkak të afërsisë territoriale ose pushtetit të ushtruar mbi popullatën më të vogël, por prania e huazimeve të jetë e kufizuar e jo edhe e tejkaluar.

Shembujt e tillë janë të shumtë si: krasit , komshi, kockë sheqeri = kokërr sheqeri, kjo fjalë përdoret edhe me kuptim tjetër: është bërë kockë e lëkurë që dmth. asht e lëkurë, kleçkë = copë e vogël dhe e hollë druri, kunj i vogël, etj. , vozit, shapkë, stol = karrigë, , sedilje = ulëse, zhabë, kolibë = kasolle, plloçë = pllakë, kovaç = farkëtar, vadit = ujis, postavë = çarçafë, prozore = dritare, plafon = tavani, etj.

Tre shembujt e fundit përdoren në gjuhën e folur nga një shtresë e caktuar njerëzish por

fatkeqësisht fjalën postavë e shohim të shkruar edhe në dyqane ku ofrojnë prodhime nga tekstili. Meqë origjina e gjuhëve sllave ballkanike si: serbishtja, kroatishtja, bullgarishtja, maqedonishtja, etj. është e përbashkët dhe në afërsi të madhe atëherë edhe identifikimi i tyre është i vështirësuar, përkatësisht gjetja e prejardhjes së tyre ose konstatimi se prej cilës gjuhë sllave është huazuar ndonjëra prej huazimeve sllave në gjuhën shqipe.

Duhet cekur se ndikimi i gjuhëve sllave në gjuhën shqipe është i dukshëm edhe në fjalëformimin me prapashtesa sllave si: icë buallicë nga fjala shqipe buall si dhe prapashtesa sllave icë; shumicë, valanicë; çkë (nga sllavishtja çka) plackë, meçkë, kleçkë, etj.

J. Gjinari në punimin e tij “Mbi disa elemente sllave në të folmet veriore të Shqipërisë Jugore” (botuar në: Studime Filologjike, 2/1966, 157-167), në mënyrë të veçantë e të hollësishtme ka shqyrtuar prapashtesat e huazuara sllave në toskërishten veriore: - kë (nga sllavishtja - ka), - çkë (nga sll. - čka), - icë, - nik, - ovinë, - it, - çe, - ishte ose - ishtë (nga prapashtesa sllave - ica, - nik, - ovina, - iti, - će, - ište).

“Kështu, elementet sllave janë më të shumta në anën e Korçës, sidomos në Devoll, dhe vijnë duke u pakësuar nga perëndimi, në anët e Beratit e të Myzeqesë, e zvogëlohet shumë numri i tyre në anët jugore, në Përmet, në Tepelenë, në Mallakastër”. [4: faqe 160].

Ndër të tjera, fakti që sllavët formuan shtetet e tyre në mesjetë dhe ato shtete (bullgare, serbe dhe kroate) pushtuan me të madhe territoret shqiptare, na jep të kuptojmë ndikimin e pjesshëm të gjuhëve sllave në gjuhën shqipe. E. Çabej në mes tjerash konstaton si vijon: “Këto marrëdhënie të Shqiptarëve me Sllavë, që zgjatën përafërsisht tetë shekuj me radhë, kanë lënë gjurmët e tyre në gjuhë”. [3: faqe 60].

Për përdorimin e sllavizmave dhe prezencën e tyre në gjuhën shqipe kanë shkruar edhe shumë gjuhëtarë të huaj si: F. Miklosichi, G. Majeri, S. Mladenovi, M. Vasmeri, P. Shoku, N. Jokli, H. Bariqi, A. Desnickaja etj. Disa prej tyre për këtë çështje kanë shkruar edhe studime të veçanta.

### Huazimet turke

Huazimet turke patën ndikim aq të madh jo vetëm në gjuhën shqipe por edhe në gjuhët e tjera ballkanike përgjithësisht. Gjatë periudhës së sundimit osman në tokat shqiptare, me përjashtim të Malësisë së Shqipërisë, që siç e vë re Liku: "...vendi asnjëherë nuk ishte nënshtruar krejtësisht"[5: faqe 250]. megjithatë ndikimi i pushtuesit osman la gjurmë të pashlyeshme tek popujt e Ballkanit dhe tek populli shqiptar e gjuha shqipe në veçanti.

"Huazimet turke, ose më mirë të themi turqizmat në gjuhën shqipe janë përhapur në disa sfera shoqërore: religjioze ose fetare, administrative, ushtarake – luftarake, ndërtimtaria dhe zejtaria, mjedisi shtëpiak si dhe jeta e përgjithshme shoqërore".[6: faqe 55].

Shumë turqizma janë përdorur në kohët më të hershme në mbarë gjuhën shqipe, madje shumë sosh edhe sot përdoren në gjuhën letrare shqipe dhe të njëjtat janë edhe në fjalorët e gjuhës shqipe. Të këtyllë janë shembujt si: aferim, sojsëz, sebeb, sevap, sevda, shejtan, zarar, millet, çakall, kasap, bosh, tamam, avlli, hamall, xhelat, jelek, sheqer, hallë, behar, kurban, karshi, kusur, ilaç, kallëp, deve, dyqan, bakall, fukara, kadife, gazep, konak, sakat, jastëk, jorgan, liman, gjol, për: liqen, hamam, taze, lezet, kurbet, misër, qese, jeshil, pazar, jetim, çadër, çare, zanat, bajrak, hurma, zahmet, derman, ashiqare, alem, adet, adalet, alet, amanet, hajvan, gjynah, dert, etj.

Në mesin e fjalëve turke gjenden edhe disa turqizma që kanë karakter krahinor, d.m.th. se janë përdorur vetëm në një krahinë ose trevë, e jo në mbarë gjuhën shqipe dhe as në mbarë toskërishten. Të tillat nuk kanë mbetur në përdorim të gjuhës së sotme letrare shqipe. Ja disa shembuj të tillë: asker, bujrum, çeshme, katijen, lazëm, exhel, sert, syret, hedije, zeman, seimen, imza, insan, kabahat, javash, jemek, ymyt, bakallhane, tyxharet, ablla, galiba, meraba, parçe, për: pjesë, fjalë e cila përdoret edhe në sllavishte, etj.

Në kuadër të prapashtesave turke ekzistojnë fjalë turke, shqipe dhe greke me prapashtesa turke – xhi, - llëk .

Shembuj: bahçexhi për kopshtar, qiraxhi, shakaxhi, jabanxhi, bojaxhi, ojnaxhi, hallexhi, xhamxhi, belaxhi, qerrexhi nga fjala shqipe qerre dhe prapashtesa turke – xhi, peshkaxhi për: peshkatar, mullixhi për: mullis, lajkaxhi për: lajkatar, etj.

Huazime turke me prapashtesën turke – llëk: pazarllëk, kollajllëk, ortakllëk, dynjallëk, hasretllëk, arallëk, boshllëk, maskarallëk, kallaballëk; nga fjalët shqipe me prapashtesë turke: egërsillëk për: egërsi, njezërlëk për: njerëzi, etj.; nga fjala greke: dhespotllëk për: despotizëm, etj.

### PËRFUNDIM

Si në të kaluarën, në të tashmen e besoj edhe në të ardhmen tonë ndikimet nga gjuhët tjera kanë qenë, janë dhe do të jenë të pranishme. Nga goja e popullit e dimë se: "peshku i madh e ha të voglin". Mirëpo, angazhimi ynë si gjuhëtarë, i mësuesve të gjuhës shqipe e të letërsisë, mësuesve të gjuhëve të huaja, puna dhe aktivitetet në këtë drejtim, duke u mbështetur edhe tek institucionet përkatëse na obligojnë që ta mbështesim dhe ta ruajmë gjuhën burimore shqipe dhe standardin e saj, ta çmojmë vlerën dhe rëndësinë e gjuhës tonë letrare të njësuar për mbarë kombin shqiptar, të mos lejohet cenimi dhe dëmtimi i vlerës së lartë kulturore kombëtare, ta kursejmë nga huazimet e panevojshme dhe të tepruara, por natyrisht edhe me mundësi të pasurimit të tij të mëtejshëm, aty ku e kërkon nevoja përmes bashkëpunimit institucional, sidomos të katedrave të gjuhës në universitetet dhe në institutet albanologjike, duke iu mundësuar pjesëmarrje të frytshme studiuësve të cilët merren me problemet e gjuhës së sotme shqipe e të normës letrare. Dhe, në këtë mënyrë ta mbrojmë identitetin dhe integritetin tonë kombëtar.

### REFERENCAT

1. Hysa, Ramazan, (2000). Fjalor anglisht – shqip, Tiranë, Shtëpia botuese: EDFA.
2. Islamaj, Shefkije, (2008). Gjuha dhe identiteti, Tiranë, BOTIMET TOENA.

3. Çabej, Eqrem, (1987). Studime gjuhësore III, Prishtinë, RILINDJA.
4. Gjinari, Jorgji, (1966). Mbi disa elemente sllave në të folmet veriore të Shqipërisë Jugore, "Studime Filologjike" 2 Tiranë.
5. Leake, William Martin, (1914). Researches in Greece, John Booth.

6. Mulaku, Latif, (1977). Seminari i kulturës shqiptare për të huaj" 3, Fakulteti i Filologjisë, Prishtinë.